



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	259 / 23
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	30. 11. 2023
VUSHTRRI - VUÇITRN	



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë: **30 nëntor 2023** e cila ishte vazhdim i mbledhje së ndërprerë të datës 27-28 korrik 2023 merr këtë:

### VENDIM

### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KUVENDAR PËR KONSTATIMIN E GJENDJES FAKTIKE NË OBJEKTIN E RI TË QKMF-SË DHE OBJEKTEVE TJERA SHËNDETËSORE

1. Me këtë vendim formohet komisioni kuvendar për konstatimin e gjendjes faktike në objektin e ri të QKMF-së dhe objekteve tjera shëndetësore në përbërjen si në vijim:

- 1.1. Mentor Hasni, anëtar i kuvendit- PDK;
- 1.2. Bujar Pllana, anëtar i kuvendit- LDK;
- 1.3. Gresa Muli, anëtare e kuvendit-LVV.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendim obligohet të bëjë konstatimin e gjendjes faktike në objektin e ri të QKMF-së dhe objekteve tjera shëndetësore, dhe pas përfundimit të këtij procesi obligohet të hartoj raport me shkrim të cili ia ofron Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për aprovim.

3. Për zbatimin e këtij vendim obligohet: komisioni kuvendar për konstatimin e gjendjes faktike në objektin e ri të QKMF-së dhe objekteve tjera shëndetësore.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit**



REPubliKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 260/23

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 30.11.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, nenit 9 të Rregullores Nr.209/20 për Dhënien e Dekoratave të datës 29.10.2020, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë **30 nëntor 2023** e cila ishte vazhdim i mbledhje së ndërprerë të datës 27-28 korrik 2023 merr këtë:

**VENDIM  
PËR NDARJEN E ÇMIMIT “KRENARIA E SPORTIT TË VUSHTRRIË”**

1. Me këtë vendim z.Rilind Musa, i ndahet çmimi “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë” për të arriturat e tij në sportin e Bodybuilding.
2. Dorëzimi i këtij çmimi bëhet në mënyrë solemne nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**  
  
**Kryesuese e Kuvendit**

